



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:004179  
Datë: 25.08.2023  
Numri i dokumentit: 04615188

**Ac.nr.3241/21**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka - kryetar i kolegjit, Frosina Sylajmani dhe Besnik Bislimaj- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses, L. M. nga fshati Sh., Komuna e P., kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit nga Podujeva, Rruga “Nuhi Gashi” pn, me objekt kontesti Pagesa e pagave për shpërblimi jubilar, me vlerë të kontestit: 1,620.00 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.13/2021, të datës 01.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më **24.08.2023**mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.REFUZOHET SI E PA THEMELTË** ankesa e të paditurës, Komuna e Podujevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.13/2021, e datë 01.04.2021, **VËRTETOHET**.

**II. Pika e II-të** e dispozitivit e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.13/2021, e datë 01.04.2021, **ngel e pa shqyrtuar**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.13/2021, të datës 01.04.2021 ka gjykuar si në vijim:

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit L. M. nga fshati Sh., Komuna e P., pjesërisht **si e bazuar**.

**Detyrohet** e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria e Arsimit, që paditësit L. M. nga fshati Sh., Komuna e P., t’ia kompensojë shumën e përgjithshme prej 688.50 euro, në emër të një page e gjysmë për shpërblim jubilar (150% të një page bazë), me kamatën ligjore prej 8%, duke filluar nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30 euro, të gjitha në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit.

**REFUZOHET** kërkesa e paditësit përtej shumës së aprovuar në vlerë prej 931.50 euro, **si e pa bazuar**.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë pala e paditur, për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, duke e kundërshtuar pjesërisht aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë vetëm sa i përket pikës I të dispozitivit të tij, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësi nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195, par.1, pika d) si dhe nenit 200 të LPK-së, gjeti se:

**Ankesa e të paditurës, Komuna e Podujevës - Drejtoria Komunale e Arsimit është e pa themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datën 12.01.2021 ka paraqitur padi kundër të paditurës për pagesën e 3 pagave për shpërblim jubilar në shumën e përgjithshme prej 1,620.00 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, i ka pohuar faktet vendimtare duke theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit, për pagesën e pagave jubilarë si për nga baza ashtu edhe për nga shuma e borxhit të kërkuar, ngase në kohën e daljes në pension të paditësit, nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja e përgjithshme kolektive e vitit 2015. Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për pagesën e pagave jubilarë ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë pa mbajtur shqyrtimin kryesor ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar, pas pranimit të përgjigjes në padi, gjykata i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor. Nga shkresat e lëndës vërtetohet

se nuk është kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura për më shumë se 40 vite përvojë pune derisa është pensionuar sipas fuqisë ligjore pas mbushjes së moshës 65 vjeçare me datën 26.06.2020, po ashtu nuk është kontestuese se e paditura nuk i ka paguar paditësit pagën prej 150% të pagës bazë në emër të shpërblimit jubilar pasi që një gjë e tillë nuk kontestohet nga palët, kjo vërtetohet dhe me provat materiale në shkresat e lëndës. Në fund gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke e mbështetur vendimin e saj në dispozitat e nenin 35 paragrafi 8, pika 8.4 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Për kamatën ligjore, gjykata e shkallës së parë ka vendosur sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 449,450 dhe 452 të LPK-së.

Në raport me pjesën e refuzuar të kërkespadi së paditësit, përtej shumës së aprovuar në shumën prej 931.50 euro, gjykata e shkallës së parë, theksoi se kërkesëpadi e paditësit për sa i përket pjesës së refuzuar është në kundërshtim me provat e lartcekura dhe me dispozitën e nenit 35 paragrafi 8, pika 8.4. e cila ka përcaktuar se: *“Punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë.”* e ku nga shkesat e lëndës konstatohet se paditësi para pensionimit ka realizuar *pagën bazë* në vlerë prej 459.00 euro, (duke llogaritur  $459.00 \times 1,5 = 688.50$  euro).

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, e aprovon në tërësi vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas setyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe as në shkelje tjera të pretenduara nga pala ankuese, dhe se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht si dhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadi së e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se nuk është kontestues që paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura për më shumë se 40 vite derisa është pensionuar sipas fuqisë ligjore pas mbushjes së moshës 65 vjeçare me datën 26.06.2020, dhe se paditura nuk ia ka paguar pagën prej 150% të pagës bazë në emër të shpërblimit jubilar.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se: me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës

03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Me nenin 35, paragrafi 8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 përcaktohet se: *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë 8.1. për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50 % të një page bazë, 8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, 8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë, 8.5. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarit ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse, 8.6. Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti ”*.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadiës së paditësit, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës ( MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensimin e shpërblimit jubilar që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadiës.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditësit në emër të pagesës për kompensimin e shpërblimit jubilar si dhe shpenzimeve të ushqimit – shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Gjykata e Apelit, i refuzon si të pa bazuara edhe pretendimet ankimore të palës së paditur se aktgjykimi është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ngase dispozita e nenit 46 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë përcakton se MASHT dhe SBASHKu angazhohet bashkarisht me Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve finaciare për Komunitat e Republikës së Kosovës me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm përcakuar me nenin 35 paragrafi 5,7 dhe 9 e kjo për faktin se me nenin 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është përcaktuar zbatimi i kësaj kontratë *“ 1. Për të drejtat dhe obligimet që nuk janë përfshirë në këtë Kontratë, zbatohet legjislacioni në fuqi dhe Kontrata kolektive e përgjithshme. 1.1. Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive, janë të zbatueshme*

*për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK - ut. 1.2. Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT - in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo - arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.*

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë është në përputhje të plotë me dispozitën nga neni 382 i LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452 paragrafi 2 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Meqë, pika e **II-të** e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, nuk është atakuar me ankesë, gjykata e shkallës së dytë, duke iu përmbajtur kufizimit ligjor nga neni 194 i LPK-së (kufinj të ekzaminimit të ankesës), si dhe institutit “Reformatio in Peius” nga neni 203 i LPK-sw, pikwn **II** tw dispozitivit tw aktgjykimit tw ankimuar nuk e shqyrtoi fare.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.3241/21 , datë 24.08.2023**

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,**  
**Besnik Feka**